



Federata e Ping Pongut e Kosovës Table Tennis Federation of Kosova

Shtëpia e Sporteve, rr. Agim Ramadani Nr 43, zyra nr 7, Prishtinë
Tel: +383.44.170.586 e-mail: fppk@fppk.com www.fppk.com

Në bazë të nenit 58 të Statutit të Federatës së Pingpongut të Kosovës, Bordi i FPPK-së në mbledhje e mbajtur më dt. 03.02.2020 merr Vendim për të publikuar kete :

KONKURS

Për pozitën e:

Zyrtarit administrativ të FPPK-së

Detyrat e Zyrtarit administrativ janë:

- mban dokumentacionin materialo-financiar të FPPK-së,
- bën pranimin e të hyrave dhe pagesën e të dalurave të FPPK-së,
- mban shënimet që kërkon kontabiliteti bashkëkohor në përputhshmëri me rregulloret e bankës,
- mban kontabilitetin për mjetet themelore dhe shpenzimet materiale të FPPK-së,
- përpilon bilancet periodike dhe përfundimtare,
- është përgjegjës për ruajtjen e dokumentacionit financiar të FPPK-së,
- zbaton vendimet e urdhëresave të kryetarit, dhe sekretarit,
- kryen edhe punë tjera sipas vendimeve dhe urdhrave të urdhërdhënësve..

Zgjedhja do të bëhet për periudhën 4 vjeçare me mundësi rizgjedhjeje përmes konkursit. Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit më hollësisht rregullohen me Kontratë të punës.

Kriteret e pranimit :

- Të jetë shtetas i Kosovës,
- Të ketë përgatitjen superiore shkollore (preferohet jurist, ekonomist,)
- Te ketë së paku 3 (tri) vite përvojë organizative në përparimin e punës profesionale,
- Të ketë rezultate evidente në organizimin e punës,
- Preferohet të njoh një nga gjuhët zyrtare të ITTF-it.
- Të jetë njohës i mire i kompjuterit
- Të posedoj shkathtësi komunikimi, përfshirë aftësinë për të interpretuar informata, dhënë udhëzime dhe përcjellë informata tek të tjerët,
- Të mos ketë rënë në kundërshtim me normat etike e morale të parimeve të lëvizjes Olimpike.
- Të ketë njohuri për pingpongun

Të drejtat, obligimet dhe përgjegjësit më hollësisht rregullohen me Kontratë të punës.

Të gjitha dokumentet duhet të dorëzohen në këtë adresë :

FEDERATA E PINGPONGUT TË KOSOVËS

Shtëpia e Sporteve Prishtinë

rr. Agim Ramadani p.n

Aplikimi mund të bëhet përmes postës dhe personalisht në adresën e cekur më lartë për çdo ditë prej orës 11.00 deri 13.00 duke filluar nga data 10.02.2020 e deri më 17.02.2020, ose në formë elektronike në email adresën fppk@fppk.com

Aplikacionit duhet ti ketë dokumentet në vijim:

- Cv e kandidatit
- Diplomat e arsimit të lartë
- Referencë
- Letër motivuese
- Letërnjoftimin
- Certifikatë për gjuhët e huaja

Afati i aplikimit zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit të konkursit në tabelën e shpalljeve në Shtëpinë e sporteve dhe web.faqe të FPPK-së.

Prishtinë
05.02.2020